

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi , me sekretaren juridike Kadrije Zymberi në lëndën penale kundër të pandehurve N. K. nga K., dhe I. A. nga K. për shkak të veprës penale, kalimi i paautorizuar i vendkalimëve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1981/2016 të dates:03.11.2016, më datën 07.11.2016, mori këtë :**

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit :

**N. K., i lindur më datën: ...**, në fsh.P., k. Gj. , me vendbanim të përhershëm ne K., R. M., rr, “...” nr. ... i martuar me gjendje të mesme ekonomike shqiptar, Shtetas i Republikës së Maqedonisë.

**I. A., i lindur me dt. ...**, ne fshatin ... , Re Maqedonisë, i martuar me gjendje te varfer ekonomike shqiptar, shtetas i R, Maqedonisë.

**Jane fajto  
Sepse**

*Me datën ..., rreth orës ..., te pandehurit N. K. dhe I. A. kalojnë vijën kufitare te Republikës se Kosoves, ne at menyre qe nga patrulla e Policise Kufitaree Stacionit olicor per mbikqyrje te kufirit –Zheger, ne udhëkryqin qe lidh fshatin Zllakuqan i Eperm r.e Maqedonise me fshatin Stanqiq te Gjilanit, Republika e Kosoves,per kontroll eshte ndaluar kombi “...” NGJYRE E ..., ME TABELA ..., te cilin e drejtonte i pandehuri I. A., ne te cilin ishte edhe i pandehuri N. K., te cilët kane hyre jasht vendkalimit te autorizuar kufitar, duke perdore rrugët malore qe lidhin Republiken e Kosoves me Republiken e Maqedonise, respektivisht rrugën malore qe lidh fshatin Zllakuqan i Eperm Republika e Maqedonise, me fshatin Zllakuqan i Poshtem dhe Stanqiq te Gjilanit, Republika e |Kosoves.*

**- me këtë ka kryer veprën penale ,kalimi i paautorizuar i vendkalimëve kufitare ose i vijes kufitare nga neni 146 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

*Andaj, në bazë të dispozitës së lartëcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,22,31 41, 42,43,46, dhe 73, të KPRK, si dhe nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton*

*Ashtu që të pandehurve N. K. dhe I. A. i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej nga 250 € (dyqindë e pesëdhjetë) euro, secilit veq e veq të cilin dënim të pandehurit do t'a paguajnë në afat prej 1 (1) muai, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.*

*Nëse të pandehurit refuzojn që ta paguajn dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë,do të ju shëndërrohet në dënim me burgim ku një ditë burgimi do të ju llogaritet nga 20 euro.*

*Obligohet që të pandehurit t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej nga 10 €, në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.*

### **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurve N. K. nga K., i lindur me datën ... në fsh. P., me vendbanim në K., rr. "... " nr ... Shqiptar, Shtetas i Republikës së Maqedonisë si dhe ndaj të pandehurit I. A. nga fsh "... " k. K., i lindur me dt...., ne fsh"... ", me vendbanim të përhershëm, shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë.*

*Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurve ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.*

*Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për dhënjen e urdhërit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurve N. K. dhe I. A., i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor.*

*Në bazë të deklaratës së të pandehurve, gjyqtari konstatoi se të pandehurit N. K. dhe I. A., pa dashje, nga pakujdesia ka kryer veprën penale, kalim i pa autorizuar i vendkalimëve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK –së.në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykim*

*Gjyqtari ka konstatuar se në veprimet e të pandehurve N. K. dhe I. A. nga K. të gjitha elementet e veprës penale,kalimi i pa autorizuar i vendkalimëve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. për të cilën janë akuzuar nga prokuroria Themelore në Gjilan.*

*Duke u bazuar në këto që u ceken më lart, gjykata e ka pranuar kërkesën e PTH dhe ndaj të pandehurve, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës*

*penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimin me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimin, nga neni 41 të KPK.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP,*

*Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Më 07.11.2016**

**Sekretarja juridike,**  
**Kadrije Zymeri**

**Gjyqtari,**  
**Ramiz Azizi**

**KËSHILLA JURIDIKE :** *Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimt të njejtit. I pandehuri njoftohet se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtimi nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formë të prerë dhe do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.*